



AUTORITETI KONTRAKTOR:
Autoriteti Rrugor Shqiptar

METODOLOGJIA E PUNIMEVE

(Faza, Ndërhyrje emergjente)

Titulli Projektit:

"NDËRHYRJE EMERGJENTE PËR MBROJTJEN E PILAVE NË
URËN E MILOTIT"



AUTORITETI KONTRAKTOR:

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr.33, Tiranë

Telefon: 04 222 3600

Email: info@arrsh.gov.al



KONSULENT :

Universiteti Politeknik i Tiranës

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë 1000

Telefon: +355 4 222 7914

Email: info@upt.al



Tiranë, Gusht 2025



AUTORITETI KONTRAKTOR:
Autoriteti Rrugor Shqiptar

PËRMBAJTJA E KAPITULJE DHE NËN KAPITULJE

1 Metodologjia e Ndërtimit	1
1.1 Mobilizimi	1
1.2 Procedurat Ligjore, autorizimet dhe dokumentacioni.....	1
1.3 Radha e kryerjes së punimeve	2

1 Metodologjia e Ndërtimit

Në këtë raport po paraqesim përshkrimin e metodologjisë të realizimit të punimeve ndërtimore të objektit, në të cilën përfshihen pozicioni i kantierit të ndërtimit dhe hapat që do të ndiqen për realizimin e tyre. Referuar projektit kjo ndërhyrje emergjente konsiston në mbrojtjen e themeleve nga gërryerja e mëtejshme deri në një periudhë kur të hartohet projekti përfundimtar i kësaj ure.

1.1 Mobilizimi

Mobilizimi përfshin fazën përpara fillimit të punimeve ndërtimore, duke filluar në ndërtimin e kantierit të ndërtimit, përzgjedhjen dhe formimin e stafeve, autorizimet nga autoritete të ndryshme, lajmërimet si edhe të gjitha aktivitetet që bëjnë të mundur fillimin e punimeve.

1.2 Procedurat Ligjore, autorizimet dhe dokumentacioni

Përpara fillimit të punimeve në objekt, do të ndërmerren këto punime parapërgatitore dhe procedura si dhe përpilimi i dokumentacionit:

- Njoftimi i Inspektoratit Urbanistik Vendor;
- Kërkesë për lidhje të energjisë elektrike në kantier;
- Kërkesë për furnizim me ujë në kantier;
- Dokumentimi i gjendjes ekzistuese të terrenit ku do të vendoset kantieri dhe zona përreth;

1.3 Radha e kryerjes së punimeve




Figura 1 Plani i organizimit të punimeve

1. Fillimisht ngrihet kantieri i ndërtimit, i pozicionuar si më lart dhe vendosen të gjithë elementët si zyra e Kontraktorit, zyra e Mbikqyrësit të punimeve, parkimet, vendet e depozitimit të materialeve, fjetoret, mensa, ambientet e tjera ndihmëse, gjeneratori, etj.
2. Nga Kontraktori të realizohet rruga provizore për futjen e makinerive e materialeve. Kjo rrugë parashikohet të ketë një gjatësi rreth 80m, gjerësi 4.5m, dhe do të konfirmohen sipas terrenit.
3. **Punimet për sistemimin e sheshit të ndërtimit (zona përreth themeleve).** Kjo do të realizohet në çdo pilë në mënyrë të njëpasnjëshme duke filluar nga të dyja anët e urës. Sistemimi i shtratit të lumit përreth pilave konsiston në nivelimin e tij deri në kuotën e gërryerjes lokale maksimale. Për pilat që gjenden në rrjedhën e lumit, të merren masa për devijimin provizor të tij.
4. **Betonimi i themeleve (pilotave).** Pas pastrimit të shtratit dhe sistemimit të sheshit të ndërtimit vijon puna me pastrimin dhe betonimin e pilotave deri në lartësinë ku shfaqen pilotat e dëmtuara (1.5÷2.5)m duke gjykuar sipas secilit rast (mbrojtjen e pilotave të dëmtuara dhe thellësisë së gërryerjes). Pastrimi i pilotave përfshin heqjen e mbetjeve organike, depozitimeve të ndryshme të lumit dhe çdo materiali që pengon lidhjen e betonit të ri me pilotat ekzistuese.

5. **Ndërtimi i blloqeve të gabionit.** Pas betonimit të bllokut të betonit (betonimi i themeleve/pilotave), në perimetër të tij do të ndërtohet një qilim me blloqe të lidhura gabioni të përmasave (1x1x1)m, me qëllim mbrojtjen nga gërryerjet lokale (shiko vizatimet). Rreshti i parë i mbrojtjes me gabiona, në krahun e djathtë dhe të majtë të pilës sipas drejtimit gjatësor, do të realizohet në një lartësi prej 2m, pra dy rreshta në lartësi me blloqe gabioni me përmasa (1x1x1)m.
6. **Në përfundim të punimeve,** sipërfaqja dhe zona përreth kantierit duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme.